



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 6431 Prot.
7

Patos më 05.03.2026.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 25.02.2026

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltarë:

1. Klaudio Alisinanaj
2. Lori Musaj
3. Artan Velçani
4. Klarida Semanjaku
5. Armand Ahmetaj
6. Ertilla Myrtaj
7. Suela Hoxha
8. Smerald Hazizaj
9. Elmira Rama
10. Renaldo Shpata
11. Vjollca Kasaj
12. Novrus Toska
13. Gani Ahmetaj
14. Shezai Sinanaj
15. Zejni Musaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Jemi në mbledhjen e radhës së këshillit bashkiak, Pjesmarrja në mbledhje është 15 këshilltarë.

Baza ligjore ku mbështetet mbledhja është neni 53 pika 4 dhe 56 pika 2 gërma a të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Lexojmë rendin e ditës

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.01.2026.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.01.2026.
- 4- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin janar 2026".

5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin janar 2026".

6- Projekt-vendim "Për miratimin e planit të masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2026".

7- Projekt-vendim "Për një ndryshim në V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025, "Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe ndërmarjeve në varësi për vitin 2026".

8- Projekt-vendim "Për miratimin e objektit "Rehabilitimi i rrugës Saliaj, Grizë Lënginas".

9- Projekt-vendim "Për miratimin e kontratës së qirasë nr. 101 prot., datë 12.01.2026 të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, me objekt qiraje "Rruga hyrëse, peshorja dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane".

10- Projekt-vendim "Për miratimin e projektit "Ngritja e shërbimit të logopedisë në Qendrën Multifunkionale" dhe vlerën e bashkëfinancimit të tij.

11- Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit 4-mujori i tretë dhe prej fillimit të vitit 2025. .

12- Informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit të vitit 2025.

Rendi i ditës është hartuar konform rregullave të përcaktuara në rregulloren e këshillit . Para se të nisim diskutimin për rendin e ditës dhe miratimin e tij dua t'ju njoftoj se ka një kërkesë nga ekzekutivi. Do t'ju njoftoj më mire personi autorizuar që është zv/kryetari bashkisë Ina Sauli.

Zv/kryetari bashkisë Ina Sauli- Atëhere e autorizur dhe nga Kryetari Bashkisë doja t'ju beja me dije se kërkojmë të tërheqim pikën 12 Informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit e cila do rishikohet dhe njëherë si material gjithashtu të shtojmë dy pika në rendin e ditës të cilat janë shqyrtuar në komisionin e ekonomisë që janë konkretisht.

Projektvendimi "Për miratimin e listës së familjeve të përfshira në aplikimin nr. 328/24 prot., datë 16.02.2026 me objekt "Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë".

Projektvendimi "Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të veta" për vitet 2027-2029. Për arsye të kapjeve të afateve i kemi futur në këtë mbledhje.

Armand Ahmetaj- Pra referuar nenit 64 pika 13 të rregullores së këshillit para se të miratojmë rendin e ditës duhet të miratojmë kërkesën e ekzekutivit e cila kërkon 2/3 e keshilltarëve që i bie 14 këshilltarë duhet të votojnë pro.

Armand Ahmetaj- kush është dakord me miratimin e rendit e ditës? Miratohet me 15 vota pro futja e çështjeve në rendin e ditës. Kalojmë në rendin e ri të ditës meqënëse i lexova shtohet pika.

Pika 12 Projektvendimi "Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të veta" për vitet 2027-2029. Për arsye të kapjeve të afateve i kemi futur në këtë mbledhje Pika 13 Projektvendimi "Për miratimin e listës së familjeve të përfshira në aplikimin nr. 328/24 prot., datë 16.02.2026 me objekt "Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë".

Kush është dakord?


Miratohet me 15 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Kludio Absinoni
Rendita Shota
Mirza Spiro
Sefir

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 643 / 8 Prot.

Patos më 05.03.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.01.2026

Armand Ahmetaj –Keni ndonjë verejtje, ndonjë kërkesë për korrigjimin e procesverbalit?
Konsiderohet i ezauruar në bazë të nenit 77 të rregullores.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Rendbhe Ispata

Klaurdia Alisnana

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Shkronja Linong



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 6431 Prot.
19

Patos më, 05 03.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.01.2026

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 30.01.2026 u morën gjithsej 6 vendime nga nr. 01 deri ne 06.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vendimi me nr. 01 dhe 04 dhe 05 i është përcjell Prefekturës për verifikim dhe ka ardhur përgjigja se vendimet janë në përputhje me ligjin.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Kludio Alsinonaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 664 Prot.
13

Patos më 05 03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin janar 2026”.

Armand Ahmetaj- Ja jap fjalën ekzekutivit .

Mitjon Nikolla – Projektvendim nr. 13 datë 17.02. 2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2026”.

Spektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Janar 2026 gjithsej 10 familje me një fond prej 52,866 (pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

Lori Musaj - Komisioni ekonomisë u mbledh ditën e djeshme dhe ka diskutuar mbi këtë projektvendim i cili ka rezultuar se është në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me katër vota pro pa asnjë ndryshim.

Armand Ahmetaj- Jeni të hapur për diskutime?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin janar 2026”.

Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 668 Prot.

13

Patos më 05 03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin janar 2026”.

Mitjon Nikolla – Projektvendim nr. 14 datë 17.02.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin janar 2026”.

Spektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Janar 2026 gjithsej 24 familje me një fond prej 83,357 (tetëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë.

Lori Musaj – Në mbledhjen e djeshme dhe ka diskutuar mbi këtë projektvendim i cili ka rezultuar se është në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me katër vota pro.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin janar 2026”.

Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 455 / Prot. 5

Patos më 05 03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e planit të masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2026”.

Çajup Refitaj – Në kushtet që të gjithë e dimë paraprakisht për rastin e zjarreve kemi hartuar këtë projektvendim për miratimin e planit të masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2026 sipas shtojcës së projektvendimit bashkëlidhur. Jemi në kohen e duhur për ti paraprirë masat dhe për të patur një plan për tu përballuar me situata të kësaj natyre, dhe në përmbushje të kriterëve ligjore përcaktuese dhe rregulluese të kësaj veprimtarie. Masat për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave

Klarida Semanjaku- Komisioni i Bujqësisë u mbledh shqyrtoi të gjitha dokumentat të cilat ishin në përputhje me bazën ligjore dhe i votoi ato me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e planit të masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2026”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Penelopa Shqaba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Klondio Alsinanaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 641/Prot.

3

Patos më 05.03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për një ndryshim në V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025, "Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe ndërmarjeve në varësi për vitin 2026".

Irisi Xhelaj - Projektvendim nr. 11 datë 13.02.2026, "Për një ndryshim në V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025, "Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe ndërmarjeve në varësi për vitin 2026". Bazuar në V.K.M-në nr. 503, 01.08.2024 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", si dhe ngarkesës së shtuar të punës në funksion të rritjes së performancës institucionale dhe nivelin e përgjegjësisë administrative dhe ligjore të këtij pozicioni vijmë me propozimin për ndryshimin e pagës nivelit të pagës të Sekretarit të Përgjithshëm, kategoria I-5, në shtesën e pozicionit 165 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë. Ftojme këshillin ta miratojë.

Lori Musaj - Në mbledhjen e zhvilluar dje kemi diskutuar mbi këtë projektvendim i cili është në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me kater vota pro.

Armand Ahmetaj - Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë Projekt-vendim "Për një ndryshim në V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025, "Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe ndërmarjeve në varësi për vitin 2026".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord ?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 640 Prot.
13

Patos më 05 03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e objektit “Rehabilitimi i rrugës Saliaj, Grizë Lënginas”.

Boreta Murati- Projektvendim nr. 10 datë 13.02.2026, “Për miratimin e objektit “Rehabilitimi i rrugës Saliaj, Grizë Lënginas

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, kreut VII-të të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 82, datë 17/12/2025 “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetin e bashkisë Patos për vitin 2026”,

Në zbatim të planit buxhetor afatmesëm dhe prioritetëve të Bashkisë Patos për vitin 2026 është parashikuar rehabilitimi i segmentit “Saliaj” në fshatin Grizë Lënginas.

Ky investim vjen si rezultat i kërkesave të vazhdueshme të banorëve të zonës, si dhe për shkak të gjendjes së amortizuar të këtij segmenti rrugor, i cili paraqet dëmtime në shtresat sipërfaqësore për shkak të mungesës së mirëmbajtjes ndër vite, mungesa e kanalit kullues për ujërat e bardha, dëmtimet e urave të kalimit në hyrjet e banesave.

Rehabilitimin e rrugës “Saliaj” përfshin sistemin e shtresave asfaltike, disiplinimi i ujërave të bardha. Objekti për rehabilitimin e rrugës “Saliaj” është e përfshirë në listën prioritare në buxhetin e bashkisë Patos dhe ne kërkojmë nga këshilli i bashkisë Patos që të miratojë objektin me emërtim “Rehabilitimi i rrugës “Saliaj” Grizë-Lënginas” me në vlerën 8,000,000 (tetë milion) leke. Financimi i këtij objekti do të mbulohet midis zërave buxhetor të investimeve në programin “Zhvillimi Ekonomik dhe Rural” për vitin 2026-2027.

Lori Musaj- Në mbledhjen e komisionit kemi diskutuar dhe mbi këtë projektvendim i cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro dhe një kundër.

Armand Ahmetaj - Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë për miratimin e objektit “Rehabilitimi i rrugës Saliaj, Grizë Lënginas”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 101/Prot.
14

Patos më 05 03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e kontratës së qirasë nr. 101 prot., datë 12.01.2026 të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, me objekt qiraje “Rruga hyrëse, peshorja dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane”.

Boreta Murati - po ju paraqesim projektvendimi nr. 08 datë 13.02.2026 “Për miratimin e kontratës së qirasë nr. 101 prot., datë 12.01.2026 të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, me objekt qiraje “Rruga hyrëse, peshorja dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane”.

Me vendimin nr. 04, datë 03.02.2025 të Këshillit të Bashkisë u miratua kontrata e qirasë nr. 161 prot., datë 15.01.2025 të lidhur midis Agjencisë së Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe bashkive të qarkut Fier me objekt qiraje “Rruga hyrëse, peshorja dhe vend- depozitimi i mbetjeve urbane” u dha dakortësia për Bashkinë Patos, për marrjen me qira 1 (një) euro, nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe bashkive të qarkut Fier të rrugës hyrëse, peshores dhe vend depozitimit të mbetjeve urbane. Kjo kontratë u nënshkrua me palë qiradhënëse Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe palë qiramarrëse Bashkitë e Qarkut Fier.

Afati i kontratës është 1 (një) vit nga data e nënshkrimit me të drejtë rinovimi dhe çmimi i qirasë do të jetë 1 (një) euro në muaj, pagesa do të kryhet nga Bashkia Fier në formën e parapagimit.

Një nga detyrat kryesore e palës qiradhënëse është dorëzimi i sendit në datën e fillimit të qirasë dhe në gjendjen fizike për të cilën palët janë dakortësuar paraprakisht me njëri-tjetrin.

Një nga detyrat kryesore e palës qiramarrëse është marrja në dorëzim e objektit brenda afatit të caktuar dhe ta përdorë atë sipas destinacionit të parashikuar në kontratë.

Pasi shqyrtoi përmbajtjen dhe kushtet e parashtruara në kontratën e qirasë me propozim të Kryetarit të Bashkisë i kërkoi Këshillit të Bashkisë:

Miratimin e kontratës së qirasë nr. 101 prot., datë 12.01.2026 të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, me objekt qiraje “Rruga hyrëse, peshorja dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane”.

Efektet financiare që do të lindin nga zbatimi i kësaj kontratës do të mbulohen nga fondi për menaxhimin e mbetjeve në Ndërmarrjen e Menaxhimit të Mbetjeve, Pastrimit dhe Gjelbërimit.

Klaudio Alisinanaj – komisioni i ligjeve u mblodh në datën 24.02.2026 dhe pasi diskutoi projektvendimin e paraqitur nga ekzekutivi e cila nuk është asgjë tjetër veç një rinovim kontrate e cila është lidhur vitin e kaluar midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara me bashinë Patos si pjesë e qarkut Fier dhe e miratuam me katër vota pro.

Armand Ahmetaj – kemi ndonjë diskutim?

Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën e nëntë Projekt-vendim “Për miratimin e kontratës së qirasë nr. 101 prot., datë 12.01.2026 të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, me objekt qiraje “Ruga hyrëse, peshorja dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj

Renaldo Shybo



Shkronj Linonaj



Klaudio Alismonaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 334 / Prot.
14

Patos më 05 03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e projektit “Ngritja e shërbimit të logopedisë në Qendrën Multifunksionale” dhe vlerën e bashkëfinancimit të tij.

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 09 datë 13.02.2026 “Ngritja e shërbimit të logopedisë në Qendrën Multifunksionale” dhe vlerën e bashkëfinancimit të tij. Pasi bëm gjithë aplikimet përkatëse Jemi shpallur fitues të projektit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i cili u miratua me shkresën me nr. 454/27 prot., datë 26.01.2026 si dhe kemi lidhur marrëveshjet e nevojshme për vijimin e këtij projekti, tani jemi në fazën e miratimit

Qëllimi kryesor është krijimi i një shërbimi të specializuar logopedik pranë Qendrës Multifunksionale Patos, i cili të ofrojë mbështetje profesionale për fëmijët dhe individët me vështirësi në të folur, të kuptuar dhe të komunikuar. Kemi rreth 55 raste megjithatë nëse ky projekt do të ketë sukses do krijoj më shumë besueshmëri dhe do ti përgjigjmi të gjithë të interesuarëve. Objektivat e këtij projekti janë:

Objektivi 1- Të sigurohet akses falas në shërbimet logopedike për fëmijët me probleme të zhvillimit të të folurit.

Objektivi 2- Të identifikohen herët vonesat dhe çrregullimet e gjuhës dhe komunikimit.

Objektivi 3- Të ofrohen terapi individuale dhe në grup sipas nevojës së çdo fëmije.

Objektivi 4- Të fuqizohen prindërit përmes këshillimit dhe përfshirjes së tyre në procesin terapik.

Kohëzgjatja e projektit do të jetë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj dhe vlera e bashkëfinancimit do të jetë e ndarë sipas viteve

Viti 2026 - 90% Fondi Social, 10% bashkëfinancim Bashkia

Viti 2027 - 60% Fondi Social, 40% bashkëfinancim Bashkia

Viti 2028 - 30% Fondi Social, 70% bashkëfinancim Bashkia

Bashkëfinancimi për vitin 2026, 10% do të mbulohet nga buxheti i këtij viti në programin “Çështje sociale”, në produktin “Mbulimi bashkëfinancim ngritja e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunksionale Patos”.

Shtim shërbimi logopedie (me një logoped), paga e të cilit do të mbulohet nga fondi i mësipërm sipas përqindjes që përmndëm

Lori Musaj- Në mbledhjen e komisionit kemi diskutuar dhe mbi këtë projektvendim i cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me katër vota pro.

Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën e nëntë Projekt-vendim “Për miratimin e projektit “Ngritja e shërbimit të logopedisë në Qendrën Multifunksionale” dhe vlerën e bashkëfinancimit të tij.

Klaudio Alisinanaj - është një projektvendim shumë i rëndësishëm të cilin do ta miratojmë sot, e mira është se duhet bërë një marketing shumë i mirë i kësaj gjëje se më në fund do kemi shërbim për logapedinë për të gjithë fëmijët që kanë probleme me të folurën apo me zërin. Është një shërbim dhe vendodhja e tij është e atij është shumë e favorshme pasi është lidhur me spitalin. Përgëzime bashkisë Patos.

Mitjon Nikolla- Kemi parashikuar disa fletë palosje dhe fletë informative që do shpërndahen me qëllim që ky projekt të bëhet sa më i njohur dhe sa më i kapshëm.

Armand Ahmetaj -Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën e dhjetë Projekt-vendim “Për miratimin e projektit “Ngritja e shërbimit të logopedisë në Qendrën Multifunksionale” dhe vlerën e bashkëfinancimit të tij.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba



Renaldo Shete



KRYETAR

Armand Ahmetaj



Klaudio Alisinanaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 642/1 Prot.

Patos më 05 03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit 4-mujori i tretë dhe prej fillimit të vitit 2025. .

Mimoza Shtëmbari - Përsëritje të gjithëve! Në zbatim të ligjit 68 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin për menaxhimin financiar dhe të kontrollit ekzekutivi sjell informacion mbi raportin e monitorimit për 4-mujorin e tretë të vitit 2025 me këta tregues. Që në fillim raportojmë që jemi përmbajtur dhe fokusuar duke realizuar qëllimet e përcaktuara në planifikimin e buxhetit të vitit 2025 të cilat kanë qënë zhvillimi urban, zhvillimi social, mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve. Referuar burimeve që përbëjnë buxhetin vendor kemi këto realizime . Buxheti i bashkisë Patos për vitin 2025 me gjithë shtesat gjatë vitit zë vlerën 955,485 mijë i ndarë në tre burime kryesore.

Të ardhurat e veta vendore

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Plani i buxhetit për vitin 2025 është miratuar me VKB 87 datë 19.12.2024, buxheti fillestar me vlerën 676,666 mijë lekë i përbërë dhe nga 3 burimet që përmenda me lart dhe është shtuar me buxhetin nga fondet e trashëguara i miratuar me vendimin e këshillit nr 03, 03.02.2025 në vlerën 278,819 milion. Realizimi faktit i ndaj plani vjen në 861 milion e 75 mijë lekë i cili përbën dhe buxhetin faktik të realizuar për katërmujorin e tretë dhe progresiv për vitin 2025. Referuar zë për zë burimeve për vitin 2025 kemi transfertën e pakushtëzuar, buxhet fillestar 228 milion është shtuar nga buxheti trashëguar 86 milion, është shtuar në fund fare shtesë granti në dhjetor të 2025, 5 milion e 41 mijë lekë. Treguesi tjetër që përbën një nga burimet kryesore të buxhetit të bashkisë për vitin 2025 është transferta e pakushtëzuar sektoriale me buxhet fillestar na është celur nga Ministria 136 milion 012 mijë lekë është shtuar me fondet e trashëguara 49 milion e 83 mijë lekë dhe është shtuar me vlerën 1 milion e 302 mijë lekë buxheti për MZSH i miratuar në nëntor të vitit 2025 nga Këshilli bashkia dhe i përkiste shpenzimeve për personelin e MZSH. Plani i të ardhurave vendore, buxhet fillestar i planifikuar 312 milion, realizimi 211 milion.

Nga realizimi 211 milion e 828 mijë është përdorur 169 milion e 393 dhe diferenca vjen e trashëguar dhe do financojë siç është miratuar te buxheti fondeve të trashëguara angazhimet e vitit 2025 por që vijnë si angazhim shtesë për 2026, shtohen buxhetit të vitit 2026 por i përkasin 2025 si anagzhime dhe miratime në këshill. Gjatë vitit 2025 kemi pasur një sërë ndryshimesh me shtatë vendime në këshillin bashkiak të cilat me objekte janë të përcaktuara dhe miratuara sipas bazës ligjore që është paraqitur në këshill gjatë nevojave që ka pas për ndryshim.

Realizimi dhe planifikimi i të ardhurave vendore siç u referova dhe më përpara plani i të ardhurave vendore për vitin 2025 ka qënë 312 mijë milion, është realizuar 211 milion ose në përqindje 68%

Në tabelën shoqëruese që përmban relacioni i informimit janë të gjitha kategoritë e taksave dhe tarfiave sipas nivelit të realizimit.

Në këtë informacion është relatuar dhe mosrealizimi dhe shkakut i mos realizimit. Mbas realizimit të të ardhurave kemi realizimin e shpenzimeve buxhetore. Gjatë vitit 2025 buxheti bashkisë Patos është programuar dhe zbatuar i shpërndarë në shtatëmbëdhjetë programe. Në tabelën shoqëruese të relacionit keni realizimin për çdo program dhe sipas klasifikimit ekonomik të cilat përbëjnë vlerën 726 milion 853 kundrejt planit 956 milion 737 ose në total realizimi buxhetit për vitin 2025 është 76%. Burimet që ngelen të papërdorura janë miratuar me VKB të janarit dhe janë shpërndarë sipas destinacionit për financimin e angazhimeve të 2025 dhe shtesë për 2026 dhe për diferencat që janë bërë shtesë në programe.

Po ti referohemi buxhetit bashkë me transfertën e kushtëzuar buxheti për vitin 2025 për bashkinë Patos kap vlerën 1 miliard e 91 milion 910 mijë lekë kundrejt planit 1 miliard e 228 milion 479 mijë lekë ose niveli duke krahasuar me burimet tona dhe transfertën e kushtëzuar realizimi vete në 89%. Në relacion keni shpërndarjen dhe peshën specifike të shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik i cili është 46% i realizimit të buxhetit i përkasin shpenzimeve të personelit, 17% shpenzimeve korrente që janë operative dhe shpenzime kapitale që janë realizuar 37%. Në relacion keni të gjitha objektet dhe statusi i çdo objekti për investime që përbëjnë shpenzimet kapitale për vitin 2025 ku kemi informacion për investimet e përfunduara, investimet që janë në vazhdim investimet që janë në fazë prokurimi sipas ligjit. Të gjitha këto zënë vlerën 268 milion 540 mijë të realizuara kundrejt 418 milion 764 të realizuara si financim po statusi është në vazhdim për çdo objekt është i evidentuar në material sipas relacionit. Vlera e projekteve që ne kemi pasur në vazhdim financimi që na kanë ardhur nga 2024 në total zënë vlerën 639 milion dhe 32 milion janë financuar në 2024 nga këto projekte. Janë planifikur 418,764 për tu financuar dhe realizuar për 2025 dhe janë realizuar me financim 268 milion 540 mijë dhe 310,144 financim 2024 dhe 2025.

Në relacion keni përdorimin dhe vendimet e këshillit për ndryshimet për fondin rezervë i cili është përdorur për ndryshimin e pagave, ndryshimet strukturore që janë bërë në tetor të vitit 2025. Kemi përdorimin e fondit të emergjencave civile në analizë si dhe analizën e realizimit dhe shpërndarjes së fondit të kushtëzuar që vjen nga pushteti qendror. Treguesit financiar të realizimit të buxhetit për vitin 2025 duke krahasuar shpenzime të përgjithshme me të ardhura të përgjithshme zënë vlerën 76% , të adhurave të veta kundrejt të ardhurave të përgjithshme 37%, të ardhura vendore kundrejt planit 100%. Shpenzime kapitale 37% shpenzime personeli 46%. Huamarrje detyrimesh 0. Nuk ka bazë krahasuese se ne vazhdojmë të mos kemi detyrime. Detyrime për vitin 2025 kemi vetëm fatura të dhjetorit të cilat sot që ne vijmë më këtë relacion janë të likujduara brenda afatit ligjor.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj



Kludio Mirinoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 768/13 Prot.

Patos më 05 03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Projektvendimi “Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të veta” për vitet 2027-2029.

Çajup Refitaj- ky projektvendim natyrisht mbështetet në dispozitat ligjore dhe ligjet të cilat rregullojnë pjesën fiskale dhe të ardhurave të cilat ne kemi si bashki, ky parashikim është ndërtuar natyrisht mbi 2 realizime faktike që i përket vitit 2024 dhe vitit 2025 por është marrë konsideratë dhe fakti i këtij planifikimi duke marrë konsideratë pjesën potenciale të bazës së taksushueshme që natyrisht është pjesa e cila ka bërë me pjesën e të ardhurave nga taksat natyrisht edhe pjesa e tarifave me cilën ne përlogarisim të ardhurat dhe tarifave që ne kemi brenda bashkisë atëherë duke futur në vlera absolute faktiku i 2024 është realizuar në vlerën 286 milion 671 mijë 2025 kemi një realizim 215 milion 170 të pritshmin e vitit 2026 e kemi parashikuar në 328 milionë 68 mijë natyrisht në planifikim kemi konsistuar dhe i kemi dhënë një rëndësi pjesës potencialit ashtu sikurse e thashë edhe në fillim të bazës së taksueshme dhe tarifave dhe shërbimeve që ofrohen nga bashkia Patos. Duke qenë në këtë logjikë kemi vijuar dhe për 2027 duke parashikuar të njëjtën vlerë kemi parashikuar ndryshime për 2028 dhe 2029 duke marrë në konsideratë një nga taksat që është ajo që ne e quajmë taksa të ndara kur në përbërjen e vetë ky grupim ka taksën e rentës minerare taksën e tatimit mbi të ardhurat personale dhe taksën e mjeteve të përdorura që realisht kanë pasur në faktik një rritje dhe është parashikuar një vlerë prej milion lekësh të reja në këto dy vite 2028-2029

Në këtë material janë paraqitur të detajuar përveç grupimit sipas llojit të taksave janë në paraqitur në tabelë dhe parashikimet 27-29 duke i marrë dhe të detajuara secilin grupim mbi bazën e zërave mbi të cilën përbëjnë këtë grupim e njëjta logjik ndërtimi është përdorur dhe këtu në parashikim janë dy

vitet e realizimit faktikë dhe parashikimet për 26 -27- 28 dhe 29 ashtu sikurse ua bëra të ditura pak më lartë në vlera

Gjykojmë në planifikim e theksoj që kemi përdorur gjykimi dhe mënyrën dhe formën e vlerësimin mbi bazat potenciale që ne kemi dhe momentalisht potencialet tona janë vlerat që ne që unë përmenda pak më lart në parashikimet 26 27 28 dhe 29.

Këto parashikime janë shtrirë për një periudhë afatmesme 2027-2029

Pra gjykojmë dhe kemi planifikuar duke parë të gjitha tregues që të kemi këto planifikime të ardhurave për këtë periudhë afatmesme 27-29

Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën e dymbëdhjetë Projekt-vendim “Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të veta” për vitet 2027-2029

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstënim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 768 Prot.

Patos më 05 03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.02.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së trembëdhjetë të rendit të ditës.

Projektvendimi “Për miratimin e listës së familjeve të përfshira në aplikimin nr. 328/24 prot., datë 16.02.2026 me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”.

Boreta Murati- Bashkia Patos ka aplikuar në thirrjen e hapur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në datë 16/02/2026 “Mbi programet e strehimit për vitin 2026”. Programi për të cilin është aplikuar ka për qëllim përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, për familjet në nevojë. Është ngritur grupi i punës ka verifikuar në terren të gjitha banesat dhe ka mbajtur procesverbalet përkatëse për secilën prej tyre ku evidentohen problematikat e konstatuara. Për secilën familje është bërë fillimisht kategorizimi i tyre sipas sipas nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, i ndryshuar, ku vlerësimi bazohet në numrin e anëtarëve, përbërjen familjare dhe nivelin e të ardhurave.

Për çdo familje përfituese janë hartuar projekt-preventivat përkatës nga Sektori i Projekteve mbi ndërhyrjet e nevojshme duke respektuar kufijtë e financimit të përcaktuara nga Ministria.

Në total janë 10 (dhjetë) familje përfituese ku vlera total e punimeve është 9,819,276.(nëntë milion e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë lekë. **Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të cilat janë bashkëlidhur projekteve dimit**

Hysen Hysbashi - Siqecë, Njësia Adm. Ruzhdie

Fluturim Dine - Dukas,

Ramiz Danaj - Ruzhdie

Kudret Rrapushaj - Patos

Petrit Hoxhaj - Rrerës

Dashuri Koçiaj -Lagjja Mustafa Matohiti, Patos

Lutfi Faslliaj- Margëlliç

Riza Memaj -Ruzhdie

Emiljano Hajderaj -Patos

Tajar Hysenaj -Patos

Renditja e familjeve janë sipas familjeve më në nevojë?

Klarida Semanjaku- Shikoj nga lista që nga njësia adm Zharrëz nuk ka asnjë person. A ka pas përkesa apo personat që kanë aplikuar nuk janë klasifikuar?

Boreta Murati- Të gjitha kërkesat që kanë ardhur në bashki ne i kemi trajtuar gjithashtu janë njoftuar për plotësim dokumentacioni. Ne kemi bërë verifikimet në terren por nuk kanë plotësuar akoma dokumentacionin. Vazhdojnë të jenë akoma në list pritje. Kjo listë është për familjet të cilat kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për tu trajtuar për përmirësimin e banesës.

Smerald Hazizaj- Kisha vetëm një sqarim, në dijeninë time ka dhe kërkesa të tjera të cilat nuk janë marrë parasysh dhe mesa shoh këtu nuk po e bëj publike po do ta them më mbrapa është një person këtu në lagjen Mustafa Matohiti që e kërkon shtëpi të dytë se nuk jeton fare në Mustafa Matohiti. Si i keni bërë verifikimet? Në bazë të kërkesës që ka ardhur apo është reale që është aty banore e Mustafa Matohitit se fare mirë mund të ishte një person Aranit Kalldrëmi i cili dhe në drejtorinë e emergjencave e ka një kërkesë të tillë për rehabilitimin e banesës së tij të djegur nga zjarri dhe përfiton këtu një person që e ka shtëpi të dytë.

Boreta Murati- ju po më thoni që në listën ekzistuese është një banor që e ka shtëpi të dytë?

Smerald Hazizaj- Po besoj se po

Armad Ahmetaj- Ju lutem shmangni gjykimet subjektive, e gjithë procedura ka një bazë ligjore nëse ne kemi konstatime mund të kërkojmë me shkrim informacion ose të ndërhyjmë në projektvendim.

Smerald Hazizaj- Si thua kryetar ta shtyjme si votim?

Armand Ahmetaj- Jo jo paragjykimi është që kjo e ka shtëpi të dytë, Bora thotë që unë jam bazuar në dokumentacion prandaj po them

Smerald Hazizaj- Ka mundësi ju lutem ta sqaroj dhe unë fjalën time dhe mos më ndërhy te argumentimi që unë kam. Nëse ti nuk the fjalët që unë po them unë mbaj përgjegjësi personale dhe ligjore dhe në qofte se kjo nuk është si po them unë më rregull por në qoftë se është ashtu si them unë?

Armand Ahmetaj- nuk më kuptove çfatë isha duke thënë, nuk na lejohen paragjykimet ose gjykime subjektive, e gjithë procedura ka një bazë ligjore nëse ne kemi konstatime që bora ka shkelur ligjin mund ta bëjmë me shkrim.

Smerald Hazizaj- unë nuk po them ka shkelur ligjin, por e ka si shtëpi të dytë se nuk është banore e lagjes Mustafa Matohiti.

Armand Ahmetaj – Ku bazohesh?

Smerald Hazizaj- Sepse nuk është pra, fizike nuk është

Smerald Hazizaj- I nderuar kryetar po të vë në dijeni se unë jam banor i lagjes Mustafa Matohiti jam rritur në i lagjen Mustafa Matohiti dhe mbi të gjitha jetoj në i lagjen Mustafa Matohiti, më mirë sesa unë këtu nuk e di askush tjetër.

Boreta Murati – Smerald të lutem nëse e ke fjalën për Dashuri Koçiaj komisioni e ka verifikuar në terren, unë kam qënë vet prezente dhe zonja ka qënë vet prezente në objektin e vet, kemi trajtuar problematikën e kam parë nga afër, e pash çfarë problemi ka pasur dhe si mund ta trajtojmë atë objekt. Siç të thash ne kemi mbledhur gjithë dokumentacionin e nevojshëm që është dokumentacioni pronësisë, të ardhurat etj. Nga Ministria ka një format aplikimi ku përcaktohet kostoja e ndërtimit për nivel të të ardhurave. Të gjithë banorët që janë këtu kanë plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Pastaj nëse zonja ka një objekt tjetër por nuk e ka në emrin e vet atëherë nuk e di.

Novrus Toska- Kush do ta verifikojë se këshilltari nuk e ngre kot atë problem, ju duhet ta tërhiqni atë emër dhe duhet ta ribini në një fazë tjetër, dokumenti mbase është i falsifikuar, nëse kjo është për një shtëpi të dytë nuk është normale është thyerje e ligjit. Këtë duhet ta verifikojmë.

Ina Sauli- Zv kryetare- Pse po meret e mirëqënë që ajo e ka një shtëpi të dytë, se kjo nuk shkon, ajo është një opinion se nuk ka një shpresë në dorë dhe ne kemi një dosje në dorë me gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Ministria që thotë kjo është banesa ky është niveli i të

ardhurave dhe mund të ketë shumë të tjerë që mund të aplikojnë që mund tju takoj por nuk plotësojnë dokumentacionin dhe mund të jenë thirrur disa herë për ti sjellë

Novrus Toska- Unë e gjykoj që ndërhyrja e këshilltarit është ndihmë për ekzekutivin ju sygjeroj që ta merni në konsideratë ndërrjen e tij.

Armand Ahmetaj- e gjithë kjo çështje ka një procedurë të caktuar përpara, nëse ne kemi konstatimet tona le ti bëjmë sipas rregullores. Le të bëhen 2 këshilltarë dhe të bëjnë peocëdurën e caktuar.

Smerald Hazizaj- Kur ju referova unë kësaj thash dhe diçka tjetër thash dhe një kërkesë të Aranit Kalldrëmit që ka marrë rastin emergjenca civile që i është djegur banesa, e mora dhe e përmenda këtë rast si rast më tepër emergjent, unë nuk jam këtu për të verifikuar konkret, jam këtu unë shoh gjënë fizike dhe reale që është në terren, dokumentacioni mund të jetë shumë i saktë unë them çfarë është reale. Nëse do vij koha për ta marrë një zonjë dhe Arani Kalldrëmi unë jam i bindur që vet komisioni do vinte dotën në zemër dhe kjo pjesë do ta kishte emrin këtu. Nëse një person është fizik aty është banor i asaj lagje dhe një person të dytë që brenda ligjit e meriton për ta pasur atë banesë si është bërë përzgjedhja kur ka dy kërkesa për një banesë?

Boreta Murati- Unë e theksova që të gjitha kërkesat që kanë ardhur pranë bashkisë janë verifikuar dhe janë njoftuar qytetarët të plotësojnë dokumentacion por deri në ditën e aplikimit kanë ardhur të gjithë dokumentacionet e plota për 10 anëtar pprandaj janë përzedhur këta 10, jo se ne nuk e kemi trajtuar dhe pjesën tjetër që kanë bërë kërkesë

Arben Shpërdheja – sa për pjesën e Aranit që është djegur banesa kemi qënë në banesë dhe i është kërkuar dokumëntacioni ai nuk ka sjell një kartë identiteti, një certifikatë familjare nuk ka sjellë një dokument dhe ne nuk mund ta trajtojmë në këtë mënyre por kemi diskutuar me titullarin e institucionit që kur të vij fondi emergjencave civile do ta trajtojmë me fondin e bashkisë për atë investim. Sa për zonjën ne i kemi hapur e-albania dhe zonja figuron pa banesë. Në Zharës kanë qënë katër banesa Prenka cobanka figuron me banim në Sheqishte por gjenden civile e ka në Fier. Unë nuk mund ti shërbej një qytetari që ka banesën në Fier. Llamba tole nuk ka sjellë lëtrat, Entela Llanaj nuk ka sjell asnjë dokumentacion dhe po të them që thirrja mbyllet në datë 16 dhe pse të penaqizojmë këta qytetar. Jnë verifikuar të gjithë një për një.

Armand Ahmetaj -Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën e trembëdhjetë Projekt-vendim “Për miratimin e listës së familjeve të përfshira në aplikimin nr. 328/24 prot., datë 16.02.2026 me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”.

Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Refaela Xeba

Kludio Blinisani

Sherez Llanaj

[Signature]

[Signature]